



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 69, datë 09.02.2023**

**PËR**

**MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT PËR Z. {...},  
GJYQTAR I GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe në pikat 1 dhe 5, të nenit 64, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës për mbarimin e statusit të magjistratit mbi motivin “*arritjes së moshës së pensionit*”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 28.02.2023.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**